



Nr. 797/ prot.

Ballsh më 22.02 2024

Lënda: Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit të Bashkiak Mallakastër.

- ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

Për dijëni: KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR

PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, neni 54 pika 2, dhe mbledhjes së mbajtur nga kryesia e këshillit, njoftohen se mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Mallakastër do të mbahet në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit pranë Bashkisë ditën e **Mërkurë, datë 28.02.2024, ora 14:00**, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 29.01.2024.
3. **Projekt-vendim:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projekt-vendim:** Për miratimin e marrjveshjes së bashkëpunimit ndërvendore për menaxhimin e landfillit (depozitim, peshim, pastrim, dhe mirëmbajta e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier.
5. **Projekt-vendim:** Për miratimin e projektit të zbatimit të objektit “Ndërtim i ujësjellësit të fshatrave Drenovë, Belishovë, Belistan, dhe Visokë” dhe miratimin në parim për shpronësimin e pronave që mund të preken dhe zhëmtimin e dëmeve që mund të lindin nga zbatimi i këtij projekti.
6. **Projekt-vendim:** Për miratimin e projektit të zbatimit të objektit “Ndërtim i ujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Aranitas” dhe miratimin në parim për shpronësimin e pronave që mund të preken dhe zhëmtimin e dëmeve që mund të lindin nga zbatimi i këtij projekti.

7. **Projekt- vendim:** Për disa shtesa në Vendimin Nr.58, datë 30.11.2023, të Këshillit Bashkiak: “Për miratimin e listës së fituesëve të bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin shkollor 2023-2024”.
8. **Projekt- vendim:** Për rishpërndarje të fondeve buxhetore për vitin 2024.
9. **Projekt- vendim:** Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.12, datë 24.02.2020, të Këshillit të Bashkisë Mallakastër, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër
10. Diskutim dhe vendimarrje mbi ecurinë e procedurës për për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë dhe kryetraëve të fshatrave në Bashkinë Mallakastër.
11. Diskutim mbi Raportin e Performancës së Këshillit Bashkiak për vitin 2023.
12. Diskutime të ndryshme.

KRYETAR KËSHILLI

Nexhmi Sulaj

